



Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung  
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

RAPORTI EKONOMIK

**GJERMANI**

**KOSOVË**

**KORRIK 2023**

NA KONTAKTONI:

[info@oegjk.org](mailto:info@oegjk.org)

## Impressum

© 2023 Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

Autorët e raportit: Sytrime Dervisholli, Udhëheqëse e Departamentit për Avokim dhe Bashkëpunim me Qeverinë, dhe Dimal Hoti, student intern.

Përmbajtja e këtij raporti mund të përdoret pa pagesë duke cituar "Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare" si burim. Megjithatë, kërkohet një kopje e informacionit të përdorur. Informacioni në lidhje me raportin është përgatitur me kujdes. Megjithatë, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe tërësinë e informacionit. Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare përjashton çdo përgjegjësi për dëmet që mund të shkaktohen nga përdorimi i informacionit të dhënë.

Kontakt: [info@oegjk.org](mailto:info@oegjk.org)

Tel.: +383 38 600 880

## Tabela e përmbajtjes

1. Karakteristikat kyçe të tregtisë së jashtme të Kosovës.....	4
1.1. Gjendja Ekonomike.....	6
2. Raportet Ekonomike me Gjermaninë.....	9
3. Zhvillime të veçanta.....	11

## 1. Karakteristikat kyçe të tregtisë së jashtme të Kosovës

Në Kosovë, në vitin 2022 rritja ekonomike arriti në 3.5 përqind e nxitur nga eksportet dhe konsumi privat—i cili vazhdon të tregojë elasticitet pavarësisht presioneve inflacioniste. Situata fiskale vazhdoi të përmirësohej, mbështetur nga qëndrueshmëria e të ardhurave – e nxitur nga efektet e inflacionit dhe fitimet nga formalizimi – dhe shpenzimi i pakët i investimeve kapitale. Rritja e PBB-së pritet të rritet në mënyrë modeste, duke arritur në 3.5 përqind në vitin 2023, megjithatë ka rreziqe për këtë perspektivë pozitive pasi presionet mund të rriten në rast të një rikthimi të inflacionit dhe rritjes më të dobët se sa pritej të BE-së.

- Ekonomia e Kosovës rritet realisht me +3,2% në vitin 2022
- IMF parashikon rritjen reale të PBB-së në +3,5% për vitin 2023
- Rritja është e theksuar për vitin 2022 në sektorët e energjisë, infrastrukturës dhe digitalizimit
- Siguria e furnizimit me energji mbetet pika e dobët e Kosovës

Ekonomia e Kosovës në shifra:

	2020	2021	2022	2023 <i>Prognose</i>
Produkti Bruto Vendor nominal në miliarda euro	6,8	8,0	9,1	10,0
Produkti Bruto Vendor / Në banor në EUR	3.800	4.470	5.100	5.500
Popullsia në milionë	1,79	1,79	1,79	1,80
Rritja reale e ekonomisë në %	-5,3	10,7	3,1	2,9
Norma e inflacionit në %	0,2	3,4	10,5	6,5
Norma e papunësisë në %	25,9	24,5	24,2	23,5
Eksportet e mallrave të vendit në miliarda euro	0,475	0,753	0,880	0,970
Importet e mallrave të vendit në miliarda euro	3,048	4,320	4,790	4,980

Vlera ekonomike e vendit, renditja botërore: Vendi 152

### Marrëdhëniet ekonomike mes Gjermanisë dhe Kosovës (milion Euro):

	2019	2020	2021	2022
Importi	447.6	427.2	611.2	610.4
Eksporti	30.9	44.0	61.8	87.8
Bilanci	416.7	383.2	549.4	522.6


Pozicioni në radhën e importeve gjermane: 116 prej 239 partnerë tregtarë në vitin 2022.

Pozicioni në radhën e eksporteve gjermane: 95 prej 239 partnerë tregtarë në vitin 2022.


### Partnerët kryesorë të tregtisë janë Gjermania, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut

Partnerët më të rëndësishëm tregtarë të Kosovës në importin e mallrave janë Gjermania, Turqia, Kina, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Eksportet kosovare shkojnë kryesisht në Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Serbi, Gjermani, Zvicër dhe Itali. Mallrat më të rëndësishme të importit të Kosovës janë minerale, ushqime dhe pije, makineri dhe pajisje elektrike; ndërsa në produktet e eksportit përfshihen kryesisht metale, produkte kimike dhe perime.

### Produktet e importuara gjermane sipas Klasifikimit Standard të Tregtisë Ndërkombëtare (SITC) për vitin 2022 (% e importit të përgjithshëm):



Produktet e eksportuara gjermane sipas SITC për vitin 2022 (% e importit të përgjithshëm):



## 1.1 Gjendja ekonomike

Ekonomia e Kosovës rritet për 3,5% në vitin 2022 falë konsumit, turizmit dhe transferimit të parave nga kosovarët jashtë vendit. Zhvillimi pozitiv në konsum dhe investime parashikojnë rritjen e prodhimit të brendshëm bruto (PBB) me 3% për vitin 2023

Në vitin 2022, Kosova si dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, u rimëkëmbën nga recesioni i shkaktuar nga pandemia. Kjo u arrit vitin e kaluar falë një konsumi të fortë privat, rikuperimit të turizmit (pushimeve të shtetasve kosovarë që jetojnë jashtë vendit) dhe rritjes së konsiderueshme të remitancave nga diaspora kosovare. Kjo çoi në rritjen reale të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në Kosovë në vitin 2022 me 3,5% (burimi: Banka Botërore).

Për vitin 2023 ekspertët e ekonomisë parashikojnë një rritje të PBB-së prej rreth 3.7%, me konsumin privat, tregtinë dhe eksportin si motorët e rritjes. Në vitin 2022, PBB u rrit me 3.5%, ku impulset më të forta erdhën nga sektori i shërbimeve financiare, tregtia me pakicë dhe me shumicë dhe sektori i prodhimit/minierave/energjisë. Megjithatë, investimet kapitale ishin në rënie në vitin 2022, edhe pse shumë projekte ndërtimore po zbatohen dhe bizneset po zgjerojnë kapacitetet e tyre të prodhimit.

Situata ekonomike e rajonit DACH (Gjermani, Austri e Zvicër) ka një ndikim të menjëhershëm në Kosovë për shkak të diasporës së madhe kosovare në këto shtete

Pasojat e luftës në Ukrainë ndikojnë në mënyrë direkte dhe indirekte në ekonominë kosovare. Importet nga Ukraina dhe Rusia bëjnë pjesë me 1,5% të totalit të importeve, mirëpo burimet e rëndësishme për industrinë kosovare si metali dhe hekuri, që janë nën sanksione nga ana e Rusisë, kanë ndikim në sektorin e prodhimit.

Për më tepër, mbi 520,000 persona me origjinë nga Kosova jetojnë dhe punojnë në Gjermani, Zvicër dhe Austri dhe dërgojnë para në vendlindje çdo muaj (260 milion euro në 2022, BQK). Prandaj është me rëndësi për Kosovën si zhvillohen këto vende ekonomikisht. Varësia e fortë nga importet e bën Kosovën shumë të ndjeshme ndaj rritjes së çmimeve ndërkombëtare, ku një fund i shpejtë i luftës në Ukrainë do të stabilizonte kushtet ndërkombëtare për Kosovën.

**Inflacioni në vitin 2022 është +11,7 % dhe pritet të arrijë rreth +5,5% në vitin 2023**

Inflacioni në vitin 2022, krahasuar me vitin e kaluar, ishte 11,7%. Kjo kryesisht është e ndërlidhur me rritjen e çmimeve të transportit, ushqimit dhe të naftës, të cilat u rritën me 19%, 15% respektivisht 12%. Për vitin 2023 pritet një rritje e çmimeve prej 5,5%, pasi nafta, energjia dhe ushqimet u rritën përsëri ndjeshëm. Ky inflacion ka ndikim në ekonominë e vendit, por edhe në mirëqenien e popullsisë. Në qershorin e vitit 2022, paga minimale u rrit nga 150 në 264 euro, ku do të përfitojë rreth 27% të të punësuarve. Megjithatë, ky nuk është një kompensim i plotë për rritjen e çmimeve, që i ngarkon shumë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe ul fuqinë e tyre blerëse.

**Përmirësim i situatës në tregun e punës edhe pse shkalla e punësimit është e ulët dhe papunësia është e lartë. Remitancat nga kosovarët që jetojnë jashtë vendit kanë një efekt stabilizues**

Me një normë të punësimit prej vetëm 29% - tregu i punës është shumë i ndjeshëm. Numri i të papunëve u ul në 24,5% në 2021, për të cilin ka disa arsye: së pari, sektorët që ofrojnë shumë mundësi për punë si shitja me pakicë dhe ndërtimi u rikuperuan dhe gjithashtu u krijuan vende të reja pune në sektorin e TIK. Së dyti, ndihmat kundër COVID-19 mund të përfitoheshin vetëm nga të punësuarit e regjistruar nga punëdhënësi. Kjo masë e Qeverisë detyroi shumë punëtorë të kalojnë nga ekonomia "joformale" në atë "formale", duke nxitur regjistrimin e të punësuarve në Administratën Tatimore të Kosovës. Remitencat nga anëtarët e familjes nga jashtë vendit (kryesisht nga Gjermania, Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara) kanë vepruar si frenues për tregun e punës. Nëpërmjet remitencave, anëtarët e familjes në Kosovë mund të kenë mjaftueshëm para për të mbijetuar, duke ulur kështu nevojën për të kërkuar punë ose duke reduktuar kërkesën për punë. Kjo mund të ndodhë sidomos në rastet kur tregu i punës në vendet e origjinës (Kosovë) nuk ofron shumë mundësi për punësim. Remitencat u rritën me 16% në 2021 dhe arritën në rreth 1,2 miliardë euro, ose 15% të PBB. Gjatë vitit 2022, remitencat u rritën 2% më shumë në krahasim me vitin 2021 (burimi: BQK).

**Eksporti i mallrave rritet në vitin 2022. Tregtia e mallrave brenda rajonit u rrit gjatë pandemisë**

Edhe pse shkalla e eksportit të Kosovës është e ulët, rritja e fortë e eksporteve të mallrave në vitin 2022 me +22% në 920 milionë euro është signifikante. Rritja e eksporteve ishte shkaktuar kryesisht nga eksportet e metaleve dhe prodhimeve metalike dhe dyshekëve. Produktet e rëndësishme të eksportit ishin perime të përpunuara, plastikë, gomë dhe mobilje. Përveç kësaj, importet e mallrave u rritën dukshëm në 5,6 miliardë euro (+30%), kështu që deficitin tregtar vazhdoi të rritet. Përgjithësisht, shkëmbimi i mallrave brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor është intensifikuar që nga shpërthimi i Covid-19. Në vitin 2022, dinamika në tregtinë jashtë vendit u vazhdua si nga ana e eksportit, ashtu edhe nga ana e importit (eksporti i mallrave +30%).

**Në shkëmbimin e shërbimeve, ekonomia kosovare fiton para. Përveç turizmit, edhe nga shërbimet e TIK**

Për dallim me tregtinë e mallrave, Kosova në tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve ka suficit. Në vitin 2022, eksportet e shërbimeve arritën në 2,5 miliardë euro (veçanërisht turizmi, shërbimet e IT-së dhe shërbime të tjera biznesi), ndërsa importet arritën në 1,1 miliardë euro (veçanërisht turizmi, transporti, shërbime të tjera biznesi, sigurimet dhe shërbimet e TIK). Shpjegimin për eksportet e larta të shërbimeve e ofron logjika e statistikave të shërbimeve, e cila klasifikon të ardhurat e turizmit si eksportet e shërbimeve. Së paku, rreth 600.000 kosovarë dhe të huaj kaluan pushimet e tyre verore në Kosovë në tre muajt e parë të vitit 2022 dhe shpenzuan mesatarisht rreth 1.000 euro për person.

**Fluksi i Investimeve të Huaja Direkte rritet dukshëm në 2021 dhe 2022. Në veçanti, përfitojnë sektorët e patundshmërive, TIK, financave dhe minierave**

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë u rritën edhe në vitin 2022 (778 milionë euro, +84%). Sektorët që morën më shumë përfitim ishin sektori i patundshmërive, TIK, shërbimet financiare, miniera dhe sektori i energjisë. Shumica e IHD vijnë nga Gjermania, Zvicra, Austria, Shqipëria dhe SHBA-ja.

**Borxhi publik i Kosovës zvogëlohet në 20,7% në vitin 2022. Deficiti i buxhetit është 3,2%**

Inkasimi i tatimeve u zhvillua shumë pozitivisht dhe arriti në total në 2.2 miliardë euro në vitin 2022 (+23.3%). Raporti më i ri i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) thekson se Kosova, krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, në periudhën 2021-22, regjistroi rritjen më të madhe të të ardhurave nga tatimet, pa ndryshuar politikën tatimore. Në anën tjetër, shpenzimet e shtetit u rritën vetëm me +4.3% në 2.3 miliardë euro, duke sjellë një deficit buxhetor prej 3,2%. Borxhi i shtetit arrin 20,7% të BIP. Qeveria po mbështet popullsinë dhe bizneset në lidhje me inflacionin me një paketë masash prej 150 milionë eurosh, e cila pa dyshim do të ketë implikime financiare në buxhetin shtetëror të vitit 2023.



## 2. Raportet Ekonomike me Gjermaninë

Eksportet e mallrave në Kosovë mbeten stabile në vitin 2022, ndërsa importet nga Kosova pothuajse dyfishohen gati dhe tejkalojnë nivelin para krizës. Kompanitë gjermane furnizuan kryesisht mjete transporti dhe pjesë këtyre mjeteve, kimikate dhe materiale plastike.

Eksportet e mallrave me Gjermaninë mbeten stabile në një nivel të ngjashëm të 88 milionë euro në vitin 2022. Importet nga Gjermania rriten me 42% në 610 milionë euro. Gjermania dërgoi automjete dhe pjesë për to (279,2 milionë euro), kimikate, plastike dhe produkte farmaceutike (126,3 milionë euro), inxhinieri dhe pjesë të tyre (50,6 milionë euro), ushqime (66,1 milionë euro) dhe pije dhe produkte duhani (19,3 milionë euro). Gjermania importoi nga Kosova plastikë dhe gomë (26,7 milionë euro), ushqime (10,6 milionë euro), produkte të tjera të përfunduara (16,2 milionë euro, veçanërisht mobilje dhe veshje) si dhe prodhimet e metaleve (17 milionë euro).

Kompanitë gjermane ofruan shërbime transporti në Kosovë dhe Kosova ofroi shërbime TIK në Gjermani, ndërsa eksportet e shërbimeve rriteshin në vitin 2021 me 43.5 milionë euro dhe importet nga Kosova shkonin në 268 milionë euro.

Në total, eksportet e shërbimeve në vitin 2022 arritën vlerën prej 2.5 miliardë euro, ndërsa importet në 1.1 miliardë euro. Kompanitë gjermane në Kosovë ofruan kryesisht shërbime transporti, e cila lidhet me prezencën e fortë të diasporës kosovare në Gjermani. Kosova priti udhëtarë në pushime, pra kosovarë që jetojnë në Gjermani në vizitë në vendlindje, dhe ofroi shërbime TIK në Gjermani.

Eksportet dhe importet e mallrave vazhdojnë të rriten gjatë tremujorit të parë të vitit 2023.

Eksporti nga Kosova në Gjermani në periudhën Janar-Mars 2023 ka arritur vlerën prej rreth 21 milion euro nga gjithsej 206 milion euro sa ka eksportuar Kosova gjatë kësaj periudhe, apo 9.8%. Gjatë kësaj periudhe produktet më të eksportuara nga Kosova në Gjermani janë: Dyer dhe dritare; Materiale ndërtimi prej plastikës dhe Kasaforta të blinduara apo të përforcuara.

Importi nga Gjermania në Kosovë në periudhën Janar-Mars 2023 ka arritur vlerën prej rreth 152 milion euro nga gjithsej 1.2 miliardë euro sa ka importuar Kosova në këtë periudhë, apo 7.8%. Gjatë kësaj periudhe produktet më të importuara nga Gjermania në Kosovë janë: Autovetura; Shufra, shkopinj, ose profile prej polimereve të vinil kloridit dhe Cigare që përmbajnë duhan.

Kosova ka deficit tregtar dhe kërkon të zgjerojë kapacitetin e prodhimit të energjisë, të diversifikojë furnizimin e saj me energji, si dhe të pozicionohet si një qendër rajonale për produkte dhe shërbime të lidhura me TIK, ndërsa industritë kryesore janë bujqësia, minierat, prodhimi i dyshekëve dhe ndërtimi.

Kosova ka një deficit tregtar të vazhdueshëm si pasojë e varësisë nga importet për të plotësuar kërkesën e konsumatorëve. Vetëm në vitin 2022, deficiti tregtar i Kosovës arriti në vlerën prej 4.7 miliardë Euro, që shënoi rritje prej rreth 800 milionë Euro krahasuar me vitin 2021 (3.9 miliardë në vitin 2021). Industritë kryesore në vend janë bujqësia, miniera, prodhimi i dyshekëve dhe ndërtimi. Eksportet kryesore të Kosovës janë hekur i prerë, nikeli, plumbi dhe dyshekë. Popullsia e Kosovës është shumë përkrahëse e investimeve gjermane në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë energjinë, minierat, telekomunikacionin, shëndetësinë, menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin. Sektori i minierave ka potencial për investime të huaja, me mbi 500 licenca eksploruese dhe të minierave të lëshuara që nga viti 2007. Qeveria po punon për të pozicionuar vendin si një qendër rajonale për produkte dhe shërbime të lidhura me TIK. Sektori i shëndetësisë ka nevojë në rritje për shërbime mjekësore, objekte dhe produkte cilësore. Menaxhimi i mbeturinave dhe riciklimi janë fusha që kanë nevojë për përmirësim për të plotësuar rregulloret e BE-së. Nevoja për shërbime financiare, ligjore, arkitektonike, inxhinierike, zhvillimin e softuerëve, marrëdhëniet me publikun dhe dizajn grafik gjithashtu kanë potencial për rritje.

#### Parku i Inovacionit dhe Trajnimit Prizren - Një Iniciativë zhvillimore gjermano-kosovare

Parku i Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) Prizren është lokacioni më unik në rajon, që nxit bashkëpunimin në një komunitet vibrant, duke synuar të bëhet qendër rajonale për inovacionin e sipërmarrjes, biznesin dhe zhvillimin e aftësive, si dhe një burim i ideve inovative dhe të suksesshme.

ITP Prizren krijon lidhje bashkëpunuese ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara në park, duke ofruar një mjedis që nxit sinergjitë ndërmjet:

- Sektori privat (kompani, ndërmarrje dhe biznese të reja)
- Sektori publik (institucionet publike, subjektet dhe agjencitë)
- Organizatat e Shoqërisë Civile (OJQ dhe subjekte të tjera jofitimprurëse), dhe
- Akademi (Universitete Publike dhe Private, institucione të tjera kërkimore dhe arsimore, Ofruesit e Arsimit dhe Trajnimit Profesional).

ITP Prizren është një iniciativë nën ombrellën e Bashkëpunimit Gjermano-Kosovar për Zhvillim dhe zbatohet dhe menaxhohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) e cila ka një rrjet të gjerë partnerësh lokalë duke filluar nga institucionet qeveritare deri tek shoqatat e biznesit (p.sh. Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe Shoqata e TIK-ut STIKK) dhe tek institucionet nga sektori i arsimit.

### 3. Zhvillime të veçanta

Lufta e Rusisë kundër Ukrainës përjashtoi COVID-19 nga lajmet. Kosova është shumë e matur në planin politik në lidhje me afërsinë e Serbisë me Rusinë.

Lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka zhvendosur vëmendjen mediale nga covid-19 tek zhvillimet në Ukrainë. Mediat kosovare janë të fokusuara në lajmet nga Evropa Lindore në lidhje me Rusinë, dhe për së afërmi përcjellin reagimin e Serbisë. Qytetarët e Kosovës këto lajme rreth situatës së re gjeo-politike i ndjekin me shumë kujdes, sidomos për shkak të faktit që Serbia ende nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Kosova iu është bashkangjitur me plot përkushtim sanksioneve të BE-së kundër Rusisë. Partia pro-ruse e Presidentit të Serbisë, SNS, siç pritej, u bë parti me numrin më të madh të votave në datën e madhe të zgjedhjeve në prill 2022 (zgjedhjet presidenciale, parlamentare dhe komunale në Beograd). Deri më tani, BE-ja mbeti në pritje të një qëndrimi të qartë të Serbisë ndaj Rusisë. Për Kosovën, një orientim i qartë nga Serbia drejt Perëndimit do të ishte i rëndësishëm, sepse deri më tani, Serbia vazhdon të mbështetet në ndihmën e Rusisë në çështjen e Kosovës

Strategjia e Energjisë 2022-2031 synon të përmirësojë furnizimin me energji në Kosovë në mënyrë të qëndrueshme. Ka një nevojë të madhe për të kapërcyer sfidat e energjisë së ripërtëritshme.

Kosova ka nevojë të madhe për të ndërtuar kapacitetet e prodhimit të energjisë së ripërtëritshme. Megjithëse ka një numër projektesh, jashtë tre parçeve të erës (SOWI Kosovo, Kitka dhe Selaci), asnjë prej tyre nuk është në zbatim. Prandaj, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Strategjinë ambicioze për Energji (2022-2031), e cila përcakton pesë qëllime strategjike: rritjen e reziliencës, zgjerimin e prodhimit të energjisë së ripërtëritshme dhe dekarbonizimit, rritjen e efikasitetit të energjisë, rritjen e integritimit rajonal në fushën e energjisë dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Me këtë strategji parashihet zgjerim ambicioz i burimeve energjetike të ripërtëritshme, reduktimi i emetimeve të CO<sub>2</sub> me 32% deri në vitin 2031 dhe shtimi i kapaciteteve të burimeve energjetike të rinovueshme me 1330 MW. Gjithashtu parashihet integrimi i tregut rajonal: Bursa e energjisë ALPEX me Shqipërinë do të fillojë në pranverë 2023, ndërsa lidhja e plotë e tregjeve në vjeshtën e vitit 2023. Deri në vitin 2050, Kosova zotohet të dalë nga përdorimi i thëngjillit, edhe pse është shteti i pestë në botë, sa u përket rezervave të thëngjillit.

Kostot për zhvillimin e prodhimit të energjisë së ripërtëritshme parashikohen të jenë rreth 2 miliardë euro, ndërsa për mirëmbajtjen e termocentraleve të qymyrit do të investohen 390 milionë euro.

Sipas strategjisë së energjisë duhet të prodhohen 1.400 MW deri në vitin 2031 nga burime të ripërtëritshme.

## Procesi i Berlinit

Procesi i Berlinit është një iniciativë e udhëhequr nga Gjermania me mandat për ta lehtësuar bashkëpunimin rajonal midis gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor – Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Serbisë – për t'u mundësuar atyre që t'i bashkohen BE-së.

Nën drejtimin e kancelarit Olaf Scholz, Procesi i Berlinit mori një impuls të ri gjatë vitit 2022. Vendet e Ballkanit Perëndimor bënë një hap përpara në Procesin e Berlinit. Me tri marrëveshje të reja për lëvizshmërinë, një deklaratë të përbashkët për bashkëpunim në fushën e energjisë, mjedisit, klimës dhe sigurisë, ato dëshmuar se janë në gjendje të bashkëpunojnë.

Pas heqjes së tarifave roaming në rajon dhe hapjen e të ashtuquajturave 'korridore të gjelbra (green lanes)', që lejonin furnizimin e shpejtë dhe me mallra dhe medikamente gjatë pandemisë, nënshkrimi i marrëveshjeve ishte suksesi i tretë i kapshëm në bashkëpunimin rajonal, që kur u krijua Procesi i Berlinit në vitin 2014.

Gjermania është e gatshme të mbështesë vendet e Ballkanit Perëndimor për transformimin e sektorit të energjisë. Deri në vitin 2030, do të ofrohen grante deri në 1 miliardë euro për të mbështetur transformimin e sektorit energjetik.

## "Open Balkan" hyri në fuqi më datën 1 janar 2023 pa Kosovën dhe shihet si një konkurrent i CEFTA-s

Më 1 janar 2023, marrëveshja "Open Balkan" ka hyrë në fuqi. Ndërsa, të gjitha gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Republika e Moldavisë janë anëtare të CEFTA-s. Me iniciativë të Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, në vitin 2019 u nis iniciativa "Open Balkan", e cila parashikon thellimin e CEFTA-s nga një marrëveshje e tregtisë së lirë në një bashkësi ekonomike pa kontrolle kufitare (Mini-Schengen). Edhe pse të gjitha gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor u ftuan të marrin pjesë në "Open Balkan", vetëm tre prej tyre - Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut - në korrik 2021 nënshkruan marrëveshjet. Kosova vendosi kundër pjesëmarrjes, sepse është kundër një roli dominues të Serbisë në Open Balkan dhe Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës siç tashmë dihet.

Sllovenia dhe Kroacia mbështesin ofrimin e WB6 me BE-në. Kosova në fund të vitit 2022 ka paraqitur kërkesën e saj për anëtarësim në BE.

Në kuadër të dërgimit të statusit të kandidatit për anëtarësim në BE për Ukrainën në qershor 2022, iniciativat brenda BE për të mos lejuar që vendet e WB6 të mbesin prapa, po shtohen. Veçanërisht, Sllovenia dhe Kroacia angazhohen në procesin "Brdo-Brijuni" për shtetet e tjera ish-jugosllave dhe Shqipërinë. Në Ministrinë e Jashtme Sllovene u emërua në shtator një "Special Envoy" për Ballkanin Perëndimor, i cili do të merret ekskluzivisht me këtë temë. Kosova ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në BE në fund të vitit 2022. Megjithatë, liberalizimi i vizave me Kosovën pritet të ndodhë në muajin Janar 2024.

Programi i qeverisë së Kosovës parashikon shumë reforma. Infrastruktura dhe digjitalizimi janë prioritete.

Kosova dëshiron të përfitojë nga ndihmat financiare të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Që të mund të marrë fondet nga "Plani Ekonomik dhe i Investimeve" për zgjerimin e infrastrukturës së transportit, qeveria duhet të përgatisë një listë prioritetesh. Në këtë listë do të përfshihen edhe Korridori European 10 nga kufiri me Serbinë në veri, nëpër Fushë Kosovë deri tek kufiri me Maqedoninë e Veriut në jug, si dhe ndërtimi i një linje hekurudhore nga Kosova në Shqipëri. Një tjetër pjesë e strategjisë së rritjes së qeverisë do të jetë hartimi i agjendës digjitale të Kosovës. Nëse këto reforma zbatohen, Kosova mund të mbyllë ato boshllëqe që ka në infrastrukturë dhe digjitalizim dhe që pengojnë vendin nga arritja e suksesit në konkurrencë me BE-në.

Nevojat janë ende të mëdha dhe Kosova mbetet një treg për t'u eksploruar

Nevojat për të arritur standardet e zhvillimit janë ende shumë të mëdha në Kosovë. Sektorët me rritje të pandryshuar janë ndërtimi, energjia, shërbimet, bankat, sigurimet dhe TIK. Falë kostove të ulëta të punës dhe një popullate të re e me njohuri të shumëfishta gjuhësore, Kosova mbetet një vend me potencial ekonomik. Në "Corruption Perception Index" të Transparency International, në mes të 180 vendeve të anketuara, Kosova është përmirësuar nga renditja e 87-të (2021) në vendin e 84-të (2022). Dhe, Banka Botërore renditi Kosovën në vendin e 57-të nga 190 shtete (2019: vendi i 44-të) në "Ease of Doing Business Index" në vitin 2020. Kështu që Kosova vazhdon të jetë në mesin e 10 vendeve më të reformuara në botë.